



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1565/2 prot

Datë 13.06.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E**  
**OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT**  
**NGRIHEN PRETENDIME**

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Rafin Company” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-01414-04-15-2024, me objekt: “*Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike*”, me fond limit 62,409,264 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 16.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.

**Ankimues:**

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Valona Konstruksion” SHPK & “Zeqillari” SHPK, me NIPT (K26330202E), me adresë: Lagja “Uji i Ftohtë”, në perëndim të Rrugës Vlorë – Oriqum, në kufi me Rezidencën Qeveritare, Vlorë

**Autoriteti Kontraktor:**

Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë, me adresë: Rruga “5 Maji”, God.17, Tiranë

**Subjekte të Interesuara:**

“Rafin Company” SHPK, me NIPT (L52125110A), me adresë: Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga “Gjik Kuqali”, godinë banimi 6-8 kate dhe 2 kate nëntokë, kati 1, apartamenti nr.4, seksioni 2, pallati “C & S”, Tiranë

Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa nr. protokollit 1565/2024 datë 12.06.2024 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Valona Konstruksion” SHPK & “Zeqillari” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-01414-04-15-2024, me objekt: “*Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike*”, me fond limit 62,409,264 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 16.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rafin Company” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.*”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat bashkimi i operatorëve ekonomikë “Valona Konstruksion” SHPK & “Zeqillari” SHPK me anë të ankesës me nr. protokollit 1565/2024 datë 12.06.2024, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Rafin Company” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht, në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Rafin Company” SHPK, të kriterëve si më poshtë: [...]

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehën qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, b) Për shërbime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.*

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i operatorit ekonomik ofertues), Personin Përgjegjës (ose drejtuesin teknik) për kryerjen e shërbimeve (me profesion inxhinier ndërtimi) të shërbimeve në objekte, i cili duhet të figurojë në listëpagesën e subjektit për periudhën Janar 2024 - Mars 2024 dhe në vazhdim, dhe të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme, Diplomë.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2024 - Mars 2024.

**Shënim:** Ky kriter (2.3.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dëshmi nga administrata tatimore për punësimin mesatar të jo më pak se 152 (njëqind e pesëdhjetë e dy) punonjësve për periudhën Janar 2024 - Mars 2024 dhe në vazhdim, të vërtetuar me dokumentacionin si vijon;

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Janar 2024 - Mars 2024.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2024 - Mars 2024.

**Shënim:** Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës, të pajisur me diploma/certifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara / liçensuara sipas Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2024 - Mars 2024 dhe në vazhdim, minimumi:

- ❖ 26 (njëzet e gjashtë) punonjës bojaxhi;
- ❖ 8 (tetë) punonjës muratorë/suvatues;
- ❖ 2 (dy) punonjës teknik ndërtimi.
- ❖ 1 (një) punonjës specialist për punime gipsi / termoizolimi.

*Për këta punonjës, ofertuesi duhet të paraqesë:*

- *Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2024 - Mars 2024.*
- *Kontratën individuale të punës të vlefshme;*
- *Dokumentacionin që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar në këtë kriter. (diplomë/certifikatë e arsimit profesional).*

***Shënim:*** *Ky kriter (2.3.5) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 13.06.2024.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fioent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**